

"ZHOPI" SH.P.K.

PERMBLEDHJE JOTEKNIKE

E RAPORTIT TE VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

**Per shfrytezimin e gurit gëlqeror " Veterek" Ura
Vajguore, Berat**

(Leja minerare e shfrytezimit nr. 779/1 dt. 20.02.2015)

TETOR 2015

PERMBAJTJA

- 6.1 Permbledhje ne gjuhe joteknike e raportit te VNM-se**

- 6.2 Pershkrim i veprimtarise, vlerave te mjedisit ne zonen e veprimtarise, Ndikimeve dhe pasojave te veprimtarise ne mjedis, si dhe masave per zbutjen e pasojave ne mjedis**

- 6.3 Pasigurite e rendesishme per veprimtarine dhe pasojat e saj ne mjedis**

- 6.4 Procesi i vendimmarrjes dhe roli i VNM-se ne kete proces**

- 6.5 Metodatat e perqasjet per vleresimin**

6.1 PERMBLEDHJE NE GJUHE JOTEKNIKE E RAPORTIT TE VNM-SE

Ne kuadrin e ketij projekti synohet te jepet ne menyre te detajuar vleresimi i ndikimit ne mjedis per objektin minerar qe kerkohet te pajiset me leje mjedisore, ne te cilin pershkruhen ne menyre te hollesishme karakteristikat fizike te projektit, marrja ne konsiderate e alternativave, pershkrimi i karakteristikave te mjedisit qe mund te ndikohet, pershkrimi i ndikimeve te rendesishme te veprimtarise, parashikimi i ndikimeve indirekte, pershkrimi i masave per zbutjen e ketyre ndikimeve dhe permbajtja joteknike e projektit.

Shoqeria " Zhopi" Sh.p.k. ka nje eksperience te gjate ne fushen e industrise minerare dhe te ndertimit. Ka filluar aktivitetin e shfrytezimit te gurit gelqeror ne objektin "Veterik" Ura Vajgurore me lejen e shfrytezimit 779, dt. 26.07.2004 si edhe me lejen mjedisore me vendimin nr. 10 te komisionit me nr. 709 prot, dt. 16.11.2006. Ne perfundim te afatit fillestar te lejes se shfrytezimit shoqeria ka plotesuar dokumentacionin dhe me date 20.02.2015 ka shtyre afatin e vlefshmerise se lejes edhe per 10 vite te tjera. Ne keto kushte shoqeria kerkon te vlefshmerine edhe te lejes mjedisore per vitet ne vazhdim. Gjate periudhes te zoterimit te lejes se shfrytezimit kjo shoqeri ka investuar per zhvillimin e ketij aktiviteti ne rruge, makineri e paisje, ndertesa etj, duke rritur nga viti ne vit grafiket e prodhimit dhe investimet. Shoqeria drejtohet nga nje staf i specializuar dhe me pervoje te gjate ne pune.

Ne vemendje te shoqerise ka qene zbatimi i kerkesave te Ligjit Minerar te Shqiperise , Ligjit per Mjedisin dhe akteve nenligjore si ne drejtim te zhvillimit dhe administrimit te ketij aktiviteti dhe kerkesave ne rritje per zbatimin e projektit te shfrytezimit , kerkesa teknike dhe zbatimit te rregulloreve te sigurimit teknik ne pune mbrojtjen e mjedisit dhe monitorimin e parametrave te karieres . Shoqeria drejtohet nga nje staf i specializuar dhe me pervoje te gjate ne pune.

Ne funksion te zhvillimit te ketij aktiviteti shoqeria "Zhopi" sh.p.k deri ne vitin 2015 ka kryer keto investime :

- Eshte lidhur objekti me rrugen nacionale

Gjithashtu shoqeria ka investuar ne sigurimin e sheshit te ndertimit dhe makinerite e paisjet e nevojshme per shfrytezimin ne kete objekt.

MJETI	SASIA	VLERA
Ekskavator	1	2.665.000
Ekskavator me zinahir	1	2.778.000
Varinsk	1	2.500.000
Automjete transporti	1	3.000.000
Magazina + Zyra	1	2.500.000
TOTAL		13.443.000

Objekti ben pjese ne bashkine Ura Vajgurore, Berat. Ne veri kufizohet nga Ura Vajgurore ; ne juglindje Veteriku ; ne perendim nga Konisbalta ; ne lindje nga Morava.

Zona ne te cilen ben pjese objekti eshte ajo e Mallakastres qe eshte njekohesisht zona me e madhe kodrinore e vendit tone, me nje siperfaqe rreth 1000 km². Shtrirja e pergjithshme e Mallakastres nga veriu ne jug eshte 60 km, kurse nga lindja ne perendim eshte rreth 40 km.

Per sa i perket kushteve natyrore, Mallakastra perben nje zone kalimtare nga Ultesira Bregdetare per ne krahinen malore jugore. Nga pikepamja etnografike ajo eshte gjithashtu nje zone kalimtare midis Myzeqese dhe Laberise. Mali me i larte ne zone eshte mali i Shpiragut me lartesi 1197.2 m, qe pasohet ne veri nga lartesi 709 ne Mbreshtan, Mali i Skrevanit 430 m, dhe vargu i Kodrave te Gorices te cilat ulen ne lartesi ne drejtim te veriut nga 295 m deri ne 161 m.



Objekti eshte shfrytezuar perpara hyrjes ne fuqi te Ligjit Minerar nga Ndermarrja e Ndertimit Berat e cila ka shfrytezuar nje sasi te konsiderueshme te rezervave por pa kriter, duke krijuar nje skarpate me lartesi rreth 40-45 m. Gjate viteve te punes shoqeria “Zhopi” sh.p.k. ka punuar per sjelljen e karieres ne gjendje te mire teknike.

Objekti ben pjese ne harten topografike te shkalles 1 : 25 000 me nomenklature k-34- 112-D-b e kufizuar nga keto koordinata :

PIKAT	Y	X
1	44 05 800	4514 330
2	44 05 680	4514 380
3	4405 750	4514 550
4	4405 665	4514 645
	4405 800	4514 700
	4405 930	4514 630
S_L = 0,05 km²		

Pakua produktive lokalizohet brenda shkembejeve gelqeror ne forme shtresore me permasat e fushes egzistuese minerare (1000x1000x100)m.Kuota me e ulet e shfrytezimit eshte +160 ndersa ajo me e larta +210 m.Trashesia e vendburimeve qe jane ne shfrytezim eshte rreth 100-200m,duke mos u kufizuar si ne thellesi e shtrirje.

Trashesia e mbuleses ne objekt pothuase eshte e pa perfilleshme. Ajo varion nga 5cm-100cm ne raste te rralla.

Gelqeroret ne kete objekt jane formacione shkembore me veti fiziko mekanike te mira si lende e pare Materiali qe do te shfrytezohet perfaqesohet nga gelqerori i cili mund te perdoretne industrine e ndertimit, famarceutike, industrin kimike, sideruregji e tjere..

Nga krahasimi i menyrave te shfrytezimit eshte zgjedhur shfrytezimi me siperfaqe. Ne kapitullin e llogaritjes se rezervave eshte parashikuar te shfrytezohen rezervat nga horizonti +60 m deri ne siperfaqe prej **1.099.923** m³, duke levizur jo me shume se 10 000 m³ sterile per ne stiva. Humbjet dhe varferimi i mineralit jane pranuar 5% ndersa thellesia e karrieres nga kuota me e larte eshte 90 m. Shkembinjte do te stivohen ne sheshet e percaktuara ne planimetrine me sheshet e depozitimit (ana grafike).

Menyra e hapjes se transheve

Menyra e zgjedhur per hapjen e vendburimit krijon mundesi per fillimin e transhese ne disa segmente njekohesisht. Transhete do te jene me gjysem seksioni, me thellesi qe varion nga 0 ne hyrje deri ne lartesine e nje shkalle. Kendi i pjerrtesise se faqes varion nga 55 ne 65° per shkembinj te forte, ndersa gjeresia e shesheve te punes do te jete 5 m me nje kalim.

Perzgjedhja e menyres se shfrytezimit

Per kushtet e vendburimit eshte zgjedhur sistemi i shfrytezimit me transport i cili eshte sistem universal i pershtatshem per çdo kusht ne shtrirje te vendburimit, shumllojshmerine e relievit dhe cfaredo fortesie te shkembinjve;

Sterilet do te ngarkohen ne automjet me ane te mjetit te ngarkimit dhe do te transportohen ne vend depozitimet e caktuara brenda kufijve te karrieres;

Shfrytezimi parashikon fillimin e punimeve nga lart-poshte (dmth nga horizonti i siperm drejt horizontit te poshtem), menyre e cila lejon zhvillimin normal te punimeve te shfrytezimit duke krijuar siguri ne pune dhe shfrytezim te njekohshem ne disa shkalle.

Radha dhe drejtimi i shfrytezimit

Radha e shfrytezimit do te jete nga lart-poshte ndersa drejtimi do te jete pergjithesisht nga kufiri ne qender. Shfrytezimi ne çdo horizont do te filloje ne gjysemtranshete e shkurtra, hapja e te cilave do te filloje krahas ndertimit te rruges. Transhete do te hapen me gjysem seksioni deri ne kufijte perfundimtare te shtrirjes ne zonen qe shfrytezohet. Horizontet do te zhvillohen sipas izohipseve te terrenit.

Rruget e hyrjes dhe te levizjes

Hapja e karieres ne shfrytezimin me siperfaqe realizon lidhjen me transport automobilistik te prodhimit e te zbulimit nga horizontet e punes ne karriere deri ne vendin e perpunimit ose tregetimit, qe realizohet nepermjet hapjes se rruges se hyrjes, e cila krijon sistemin e rrugeve te transportit dhe pergatitjen e horizonteve te punes per shfrytezim. Kjo rruge eshte hapur nga shoqeria dhe eshte kryer lidhja me rrugen nacionale Durres - morine

6.2 PERSHKRIM I VEPRIMTARISE, VLERAVE TE MJEDISIT NE ZONEN E VEPRIMTARISE, NDIKIMEVE DHE PASOJAVE TE VEPRIMTARISE NE MJEDIS, SI DHE MASAVE PER ZBUTJEN E PASOJAVE NE MJEDIS

Punimet e zbulimit

Ne fazen e pare do te vazhdoje pergatitja e siperfaqes qe do te shfrytezohet. Nga verifikimi ne terren rezulton qe ne zonen qe do te kryhen punime zbulimi dhe rreth saj nuk ka infrastrukture te ngritur si ndertesa, rruge, linja tensioni etj duke thjeshtuar procesin e cvendosjes se tyre.

Proceset kryesore ne kryerjen e punimeve te zbulimit jane: rrezimi, ngarkimi, transporti dhe stivimi i shkembinjve.

Gjate zhvillimit te ketij aktiviteti do te prodhohen dhe levizen per ne sheshet e depozitimit mbulesa shkembore prej 10000 m³.

Punimet e ngarkimit.

Per kapacitetin vjetor te karrieres, ekskavatori do te perballoje volumin e punes prej 60 000 m³/vit.

60 000 m³/vit : 264 dite/vit = 230 m³/dite.

Numri i ekskavatoreve do te jete 1 (nje).

Transporti ne zbulim dhe prodhim.

Volumi i pergjithshem qe do te transportohet do te jete 60 000 m³/vit e do te depozitohen ne sheshet perkates ne distance transporti te shkurtra qe variojne nga 10-15 m deri ne 150-200 m. Automjetet qe do te perdoren per transport do te jene veteshkarkuese me kapacitet te kazanit 15 m³.

Punimet e shpim-plasjes

Fortesia e shkëmbinjve sic u parashtrua me larte eshte e tille qe ben te domosdoshem perdorimin e punimeve me lende plasese. Prodhimi i gurit gelqeror ne karriere eshte projektuar 60 000 m³ ne vit duke rezervuar te drejten e shoqerise qe ne funksion te kerkesave te tregut te argumentojne rritjen e vellimit te prodhimit deri ne shfrytezimin e tij ose ne mungese tregu uljen e tij, ne programet vjetore qe harton dhe miraton ne organet qe me ligje bejne administrimin e tyre. Menyrat e hapjes e pergatitjes se objektit per shfrytezim te pershkruar me larte sigurojne rritje prodhimi mbi ate te projektuar duke rritur numrin e horizonteve dhe fronteve te punes.

6.3 PASIGURITE E RENDESISHME PER VEPRIMTARINE DHE PASOJAT E SAJ NE MJEDIS

Vleresimet e ndikimeve ne fazen e shfrytezimit mund te ndryshojne me ate te fazes pergatitore dhe instalimit te teknologjise, megjithate disa lloje ndikimesh, pasojat dhe receptoret e ndikimeve jane te njejte me te paret si p.sh. emetimi i pluhurave. Ky ndikim eshte i njejte nga pikpamja cilesore, por ndryshimi ne fazen e shfrytezimit qendron ne aspektin sasior te tij si p.sh. kohezgjatja e ndikimit, ekspozimi ndaj tij pasi lidhet edhe me harten e transportit, vlera e ndikimit apo sinjifikanca e tij.

Identifikimi dhe vleresimi i rreziqeve te tjere per fazen e operimit dhe shfrytezimit te objektit

Nisur nga natyra e veprimtarise qe kerkon perdorimin e makinerive dhe lendeve plasese dhe duke marre ne konsiderate faktore natyrore qe mund te favorizojne shfaqjen e situatave jo te zakonshme, gjate fazes se operimit mund te identifikohen edhe ndikime te tjera si:

Erozioni dhe levizja e grimcave minerale nga objekti, qe do te thote ushtrimi i ndikimit te tyre jashte kufijve te objektit, me pasoja sidomos ne trupat ujore te zones. Erozioni do te kontrollohet permes masave te parashkuara ne Planin e Menaxhimit. Sterilet do te sistemohen dhe perdoren gjate rehabilitimit duke sherbyer si faze ndarese midis shkëmbit dhe mases se dheut. Ne kete menyre ato sherbejne per stabilizimin dhe krijimin e agregateve strukturore te tokes, porozitetin dhe drenazhimim.

Ndikim i botes se gjalle nga veprimtaria. Megjithate kohezgjatjen e shkurter te parashikuar per shfrytezimin e veprimtarise, lloje te ndryshme faunistike ne objekt do te gjenden nen presion te vazhdueshem, sidomos nga zhurmat. Keto ndikime jane te pashmangshme por masat per zbutjen e tyre mund te rezultojne te sukseseshme ne fazat e ndryshme te zhvillimit te biodiversitetit, veçanerisht gjate ciklit te riprodhimit. Keto masa do te mund te zbatohen me me teper efikasitet gjate vitit te dyte te shfrytezimit mbasi te jete njohur mire sjellja e biodiversitetit ne objekt. Njekohesisht mund te ndodhe demtim habitati dhe folesh te llojeve biologjike me status te veçante mbrojtjeje

Gjate kesaj faze do te ndodhin disa ndryshime te pakthyeshme dhe te pashmangeshme ne pejsazhin, topografine dhe gjeologjine e siperfaqes ku do te terhiqet minerali. Siç shihet edhe nga profili gjeometrik i karrieres (shih raportin teknik) do te krijohen shkalle paralele te cilat do te paraqiten si brezare te gjelberuara ne fazen e rehabilitimit te karrieres.

Aksidente te mundshme te punonjesve gjate proceseve teknologjike ne objekt, veçanerisht gjate kryerjes se shperthimeve.

Duhet kuptuar qe probabiliteti qe secili nga skenaret e mesiperm te ndodhe do te varet shume nga masat qe do te parashikohen dhe zbatohen ne Planin e Menaxhimit.

Vleresimi i ndikimeve ne fazen e mbylljes se karrieres

Mbas shfrytezimit te objektit dhe mbylljes se veprimtarise eshte planifikuar te realizohen punime rehabilitimi te konceptuara ne dy faza sipas natyres se punimeve dhe qellimit te tyre.

Operacionet per rehabilitimin e karrieres do te realizohen,

- per largimin e makinerive,
- per sistemimin dhe pershtatjen e siperfaqes se karrieres per rehabilitim,
- per mbjelljet dhe kujdesin per rehabilitimin e karrieres.

Ndikimet me te mundshme qe lidhen me kete faze jane:

- Emetime pluhurash dhe zhurmash gjate procesit te çmontimit dhe sistemimit te dherave neper shkallet e karrieres,
- Emetime gazrash si pasoje e levizjes dhe transportit te pajisjeve,
- Derdhje aksidentale karburanti dhe hidrokarburesh nga mjetet e transportit.

Keto jane ndikime te pashmangshme plotesisht por kompania do te marre masat e duhura qe te minimizohen ne maksimum, sidomos duke planifikuar eficencen dhe ulur kohezgjatjen e realizimit te operacioneve.

Qellimi kryesor i pergatitjes se planit te masave eshte shmangia, zbutja dhe kompensimi i mundshem i ndikimeve negative me qellim qe te reduktohen ndikimet deri ne nivelet e pranuar. Per te shmangur dhe menaxhuar sa me mire ndikimet negative ne mjedis te shkaktuara nga operacionet e punes te pershkruar me siper, kompania nepermjet personelit te saj ka perpiluar dhe do te zbatoje nje plan efikas menaxhimi te ndikimit ne mjedis.

Vleresimi i sinjifikances se ndikimeve nenkupton sa e ushtron veprimtaria e propozuar ndikimin ne mjedisin natyror dhe socio-ekonomik brenda konceptit kohe dhe eshte nje nder aspektet me te rendesishme per tegjkuar mbi te. Qellimi per te cilin u vleresua sinjifikanca e ndikimeve eshte te vleresimi i veprimtarise ne menyre objektive propozimi i masave efikase per minimizimin e ndikimeve thelbesore.

Ndikimet mjedisore te karrieres do te zvogelohen duke zbatuar me korrektesi teknikat e meposhtme:

- Piketim te sakte te siperfaqes se shfrytezimit dhe operim vetem brenda saj,
- Kontrolli i pluhurave permes lagies se zones se punes dhe mbulimit te kamioneve gjate transportit,
- Kontrollin e dherave te gjeneruara dhe sistemimin e tyre me ane te kompaktesimit te dherave dhe mbjelljes se shkurreve qe do te dalin nga pastrimi dhe hapja e karrieres me qellim rivegjetacionin e shkalleve,
- Hapjen e kanaleve te nevojshem per te drejtuar ujerat e shiut dhe erozionin,
- Perdorim te mireplanifikuar dhe kontrrolluar sipas rregullores se sigurise te lendeve plasese
- Kontroll teknik i mjeteve te punes per te parandaluar rrjedhjet e karburantit

RREGULLA TE PERGJITHSHME PER SIGURIMIN TEKNIK DHE MBROJTJEN NE PUNE.

Drejtuesit teknike te karrieres, duhet t'u bejne te diture punonjesve:

- *Procesin teknologjik te operacioneve ne teresi ne karriere dhe te punes ne frontin ku punon.*
- *Pajisjet dhe makinerit qe perdoren ne karriere.*
- *Shkaqet e aksidenteve dhe masat per menjanimin e tyre.*
- *Rregulloret e sigurimit teknik dhe mbrojtjes ne pune, aktet nenligjore dhe udhezimet ne zbatim te tyra te leshuar nga dikasteret qe lidhen me to.*
- *Vecorite e punes ne karriere ku do te punohet, rregullat e sigurimit teknik dhe te mbrojtjes per menjanimin e aksidenteve.*
- *Rregullat e sigurimit teknik qe lidhen me frontin e punes, makinerite dhe profesionin qe kryen cdo punonjes, per mbrojtjen e vehtes dhe punonjesve te tjere qe punojne ne karriere ose te vizitoreve.*
- *Rregullat e pergjithsme te sigurimit teknik ne karriere per tu mbrojtur nga renia e copave te shkembinjve, punet me lende plasese, makinerite, rrymat elektrike, shkarkesat atmosferike etj...*
- *Ndihmen e pare shendetsore.*
- *Vendosja ne territorin e karrieres dhe ne territorin e hyrjes se saj, ne vendet te dukshme dhe naten te ndricuara me pjeset kryesore te Rregullores se Sigurimit Teknik.*
- *Te krijoje punonjesve kushte te mira pune dhe mjete mbrojtese.*
- *Te beje instruktimin paraprak dhe periodik te punonjesve, dokumentat sipas formularit te percaktuar ne Rregulloren e Sigurimit Teknik.*

Punonjesit qe jane te punesuar ne karriere duhet:

- *Te njohin mire teknologjine e perdorimit per prodhimin e mineralit me karriere.*
- *Te njohin Rregulloret e Sigurimit Teknik dhe mbrojtjes ne pune te leshuar nga Inspektoriati i Sigurimit Teknik dhe t'i zbatoje ato ne pune.*
- *Te dine mire shkaqet e mundshme te aksidenteve ne zbatimin e projektit per cdo proces pune ne karriere.*
- *Te siguroje veten dhe punonjesit e tjere gjate procesit te punes ne karrier.*
- *Kur konstatojne shenja te nje avarie te mundshme qe eshte burim aksidenti, ne radhe te pare merren mase per eliminimin e saj, nderkohe lajmerohen gjithte punonjesit per rrezikun dhe ve ne dijeni drejtuesin teknik te karrieres.*
- *Te perdorin mjetet mbrojtese individuale ne pune, si kapelen e minatorit, rrobat dhe cizme pune, dorezat, maskat mbrojtese nga pluhuri dhe zhurma.*
- *Te kene njohuri te mjaftueshme per ndihmen e shpejte.*

Rregullat e sigurimit teknik ne frontin e punes.

Gjate punes ne karriere projekti parashikon zbatimin me rigorozitet te rregullave te sigurimit teknik dhe mbrojtjes ne pune. Me poshte jepen drejtimet kryesore te mbrojtjes ne pune, me te detajuar ato do tu mbeten te ditura punonjesve nga drejtuesi teknik punimeve.

- *Frontet e punes ne karriere po te punohet naten ato duhet te ndricohen me projektore qe furnizohen nga rrjeti elektrik ne menyre te pa varur nga ndricimi i mjeteve motorike. Kur mungon ndricimi ndalohet puna.*
- *Ndalohet qendrimi i punonjesve ne buzet e sipërme dhe te poshtme te skarpatave te shkalleve dhe levizja ne to. Kalimi nga nje shkalle ne tjetren behet vetem me rruge kalimet e hapura per kete qellim.*
- *Ndalohet qendrimi dhe kalimi i punonjesve brenda rrezes se veprimit te mjeteve ngarkuese dhe transportuese kure ato jane duke punuar.*
- *Ndalohet likuidimi i avarive dhe grasatimi i makinerive dhe punimet e tjera kur ato jane ne levizje.*
- *Kure konstatohet se nga skrapat e shkallve ka rreshqitje massive dhe ne raste kur ka shira dhe furtune, ndalohen punimet dhe njerezit dhe mjetet largohen ne vende te sigurta.*
- *Cdo turn përpara se te filloj nga puna ben kontrollin per minat te paplasura dhe gjendjen teknike te makinerive.*

6.4 PROCESI I VENDIMMARRJES DHE ROLI I VNM-SE NE KETE PROCES

Ne kuadrin e ketij projekti synohet te jepet ne menyre te detajuar vleresimi i ndikimit ne mjedis per objektin minerar qe kerkohet te pajiset me leje mjedisore, ne te cilin pershkruhen ne menyre te hollesishme karakteristikat fizike te projektit, marrja ne konsiderate e alternativave, pershkrimi i karakteristikave te mjedisit qe mund te ndikohet, pershkrimi i ndikimeve te rendesishme te veprimtarise, parashikimi i ndikimeve indirekte, pershkrimi i masave per zbutjen e ketyre ndikimeve dhe permbajtja joteknike e projektit.

Per kete arsye jane objekt erozioni masiv. Keto toka karakterizohen nga permbajtje mesatare humusi, reaksion nga pak acid ne neutral, kompleks thithes te madh dhe saturim te larte me baza, kryesisht me Ca dhe Mg, horizont iluvial karbonatik, argjilim dhe ngjeshje ne horizontet e mesme te profilit. Formula e profilit eshte A-AB-B-BC-C ose A-AB-BC ose A-AC-C.

Perfaqesuesit efuzive te ketij rajoni jane diabazet, porfiritet diabazike, porfiritet bajamore dhe dajkat keratofirike.

Ne te gjithe rajonin perreth vendburimit, tradicionalisht, zhvillohen aktivite ekonomike minerare, gje qe ka ndikuar edhe ne llojshmerine faunistike te pranishme ne te. Ne zone nuk egziston mundesia e strehimit te gjitareve te medhenj te cilet t'a perdorin ate si arela per sigurimin e ushqimit, ndersa formacionet me shkurre sherbejne si zona te pershtatshme per fshehjen dhe kullotjen e zvarranikeve te tille si breshka e zakonshme (*Testudo hermani*), apo zhapikeve si specia e *zhapiu te gjelbert (Lacerta viridis)*. Lendinat e hapura me bimesi barishtore paraqiten me rendesi per kullotjen e iriqit

Zona ne te cilen do te zhvillohet aktiviteti nuk gezon status te vecante si zone e mbrojtur, pasi flora dhe fauna jane shume pak te zhvilluara. Terreni pergjithesisht eshte shkembor, pothuaj i zhveshur dhe i mbuluar me barishte e shkurre shume te rralla.

Rajoni ne studim pershkohet nga nje rrjet i dendur perrenjsh dhe rrekezash me karakter stinor. Periferia e zones ku ndodhet objekti ka nje shperndarje karakteristike te tyre. Ushqimi i vetem i prurjeve jane rreshjet e shiut dhe debores. Tipar karakteristik i regjimit hidrologjik eshte luhatja e theksuar e niveleve te tyre gjate vitit, e cila lidhet kryesisht me nivelin e reshjeve. Periudha me prurje te shumta shfaqet gjate muajve tetor-maj dhe me prurje te pakta qershor – shtator. Rrjedhja minimale eshte e lidhur me reshjet e pakta dhe avullimin e fuqishem per shkak te

temperaturave te larta. Rrjeti hidrografik i perrenjve perben zonen e drenimit edhe per objektin qe do te shfrytezohet.

Sipas klasifikimit klimaterik te vendit tone te bere nga Instituti Meteorologjik i Akademise se Shkencave, zona ne te cilen ndodhet objekti ben pjese ne nenazonen qendrore te zones klimatike mesdhetare kodrinore. Dimri pergjithesisht eshte i bute dhe me lageshti, kurse vera eshte e nxehte dhe e thate. Kjo zone ka mbi 2500 ore ndricim dielli ne vit.

6.5 METODAT E PERQASJET PER VLERESIMIN

Çdo aktivitet qe zhvillohet ne mjedis shoqerohet me pasoja dhe ndikime ne mjedis qe jane pjese e atij kompromisi qe shoqeria jone ka zgjedhur per t'u zhvilluar. Megjithate e rendesishme eshte qe te kuptohet natyra e ketyre proceseve, forma e shfaqjes se tyre dhe me analitikesht ndikimet e çdo operacioni te kryer, sidomos mbi burimet natyrore te parinovueshme.

Industria minerare eshte shume e rendesishme ne eknomine e nje vendi, por ajo shoqerohet edhe me ndikime mjedisore negative te cilat ne disa raste mund te jene te pashmangshme. Shume prej ndikimeve negative mjedisore mund te minimizohen permes nje planifikimi te kujdesshem mjedisor dhe aplikimit te teknikave dhe teknologjise se parandalimit te ndotjeve.

Vleresimi i ndikimeve te mundshme si pasoje e veprimtarise behet duke u nisur nga nje sere faktoresh qe lidhen me natyren e veprimtarise, teknologjine e perdorur, menyren e operimit, sasine e energjise, lendet e para te perdorura dhe mbetjet e gjenerura, te gjitha keto ne kontekstin e mjedisit fizik, biologjik dhe socio-ekonomik.

Kur flasim per shfrytezim te resurseve minerare duhet te marrim ne konsiderate perdorimin e makinerive te renda, te ekspoloziveve si dhe zhvendosjen e transportin e sasive te medha te mineralit nga nentoka.

Bazuar ne menyren e propozuar per shfrytezim ndikimet me thelbesore mund dhe duhet te analizohen sipas fazave te veprimtarise, konkretisht,

- ne fazen pergatitore/instalimeve/rikonstruksionit dhe kryerjes se punimeve te reja
- ne fazen e shfrytezimit
- ne fazen e mbylljes, rehabilitimit te objekteve dhe riaftesimit te proceseve natyrore.

Eshte e rendesishme te kuptohet natyra e ketyre proceseve dhe forma e shfaqjes se tyre, direkte ose indirekte, ne menyre qe te percaktohet qarte lloji i ndikimeve:

- *Ndikime te kthyeshme ne mjedis*
- *Ndikime te pakthyeshme ne mjedis*

Te dy llojet e ndikimeve mund te minimizohen ne terma relative ku qellimi kryesor eshte mbajtja e tyre brenda siperfaqes se objektit te kerkuar dhe krijimi i kushteve natyrore per te siguruar riaktivizim e proceseve te natyres dhe rigjenerim te ekosistemit.

Per vleresimin e ndikimeve ne mjedis te projektit u ndoqen hapat e meposhtme:

- njohja me projektin dhe teknologjine e tij, menyra e propozuar per shfrytezim,
- njohja me natyren e operacioneve te nevojshme ne mjedis,
- njohja me vlerat natyrore dhe mjedisore te zones dhe siperfaqes,
- historiku i nderveprimit mjedisor te minieres me zonen,
- konsultimi me shume dokumenta e raporte te VNM per veprimtari te njejta.

Subjekti do te kujdeset per administrimin e çdo informacioni qe lidhet me ushtrimin e veprimtarise. Administrimi i te dhenave konsiderohet shume i rendesishem per menyren e operimit te subjektit dhe do te perdoret per te permiresuar eficencen e çdo mase te parashikuar per zbutjen e ndikimeve ne mjedis dhe ne teresi. Per mbajtjen e te dhenave do te perpilohet nje regjister i veçante, fushat e te cilit te mbulojne te gjithe llojin e informacionit te mbledhur qe lidhet me aktivitetin e minieres.

Pergatiti

“STUDIME PROJEKTIME MINERARE” sh.p.k.

Inxh. Miniere-Markshejder:

Halil BULICA

Inxh. Miniere:

Ardian BRAKO

Ekspert Mjedisor :

Hysen DOÇI

